



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**  
**DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LIÇENSIMIT**

AN180820200001

Tiranë, më: 23.10.2020

Vendimi 54

**DEKLARATE MJEDISORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

**VENDOSI:**

**Lëshimin e Deklaratës Mjedisore negative, për Zhvilluesin me të dhënat si më poshtë:**

**Personi juridik:** “PRELA MERMER” Sh.p.k.

**Nr. NIPT-i:** L77824301S

**Adresa e selisë:** Autostrada Laç-Mamurras, km 1, Ndërtese 1 katëshe, Zk nr.1768, me pasuri nr. 47/15, Laç.

**Personi përgjegjës:** Gëzim Prela

Për të zhvilluar projektin “**Karrierë për shfrytëzimin e gurit gëqeror të mermerizuar**”

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proedurës së Thelluar të Vlerësimin të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

**Vendndodhja:** Zona Minerare Nr.327/2, Objekti i Gëlqerorit te Mermerizuar “Mërtur”, Fushë Arrëz, Bashkia Shkodër

*(Bashkangjitur Anex 1 Harta dhe koordinatat)*

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr.10440, date 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

*Refuzimi i kërkesës për leje/licencë zhvillimi për atë projekt, për shkak të ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis me pasoja afatgjata, që dëmtojnë cilësinë e mjedisit dhe nuk mundësojnë përmbushjen e standardeve mjedisore përkatëse*

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr.10440, datë: 7.7.2011, "Për vlerësimin ndikimit në mjedis", të ndryshuar, më poshte po listojmë:

### **1. Qëndrimin e Drejtorive Teknike:**

*Drejtoritë teknike të ministries shprehin mendimin si më poshtë vijon:*

Drejtoritë teknike konstatuan se:

**1- nuk jepen të dhënat kadastrale për sipërfaqen pyjore që do të përdoret,**

**2 - baza ligjore për pyjet nuk është ajo që duhet,**

**3- nuk shpjegohet si do të bëhet konkretisht rehabilitimi, çfarë ndodh pas projektit, si mund të jetë mjedisi pas rehabilitimit, kjo duke patur parasysh edhe që sipërfaqja ku do kryhet aktiviteti është në kufijtë e sipërm të vegjetacionit (flitet për vitin e 6-të ku fillon rehabilitimi, pastaj përshkruhet se do fillojë kur të mbarojë shkalla e parë e gërmimit, etj.), çfarë mendohet se mund të mbillet dhe si.**

*Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Sipërfaqja e kërkuar nuk bie në zonë të mbrojtur.*

*Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkoder Lezhë Kukës shprehet: jep mendimin pozitiv për propozimin në fjalë për shkak se mendojme që nderveprimet dhe ndikime negative në mjedisin egzistues janë të rikuperueshme.*

**2. Ministria ka marrë në shqyrtim mendimet e shprehura nga publiku dhe institucionet përkatëse, si dhe shkallën e reflektimit të tyre;**

### **3. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Agjencia Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitorëve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

### **4. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:**

- Të plotësohen kërkesat në bazë të Urdherit Nr.67 date 11.03.2018 "Për miratimin e Planit të Veprimit për veprimtaritë minerare me karrierë (guroret).
- Nuk jepen masat që janë marrë lidhur me rehabilitimin e sipërfaqes së shfrytëzuar deri tani.
- Në raportin e thelluar të VNM-së subjekti nuk ka mbajtur parasysh të gjitha sugjerimet e bëra në fazën e njoftimit për çështjet që duhet të trajtonte në raportin e thelluar të VNM-së sa i takon menaxhimin të mbetjeve që do të gjenerohen gjatë zhvillimit të aktivitetit.

- Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, nuk janë përshkruar masat konkrete i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM**

**EDISON KONOMI**

**MINISTRI**

**BLENDI KLOSI**

*Konceptoi:*

*Miratoi:*

1. Anex 1.Harta dhe koordinat



Harta topografike në shkallë 1:25000 e zonës minerare Nr. 327/2



Pika	Y	X
1	44 12 685	46 78 875
2	44 13 088	46 78 614
3	44 13 080	46 78 380
4	44 12 882	46 78 386
5	44 12 850	46 78 505
6	44 12 727	46 78 550
Sip = 0.111 km <sup>2</sup>		